



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prudato Received / Delivety	12.04.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHK	2037 / 2022		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.166/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, Arben Mehmeti dhe Jeton Kocanëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.166/2022 të datës 24.02.2022 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_ Prishtinë, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 12.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Anullohet Formulari i Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2021, për ankuesen \_\_\_\_\_ datës 26.01.2022.
- II. Obligohet Drejtori i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale, që të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021 brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatim të këtij vendimi si në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja \_\_\_\_\_ nëpunëse civile në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, më datë 24.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 975/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Punës për vitin 2021, me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga mbikëqyrësi i saj i drejtpërdrejt është jo



objektiv, i padrejtë dhe tendenciozë dhe se janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zyrtaret Publikë dhe Rregullores për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Administrimit e Pushtetit Lokal, ndërsa kjo e fundit me datë 11.03.2022 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me shkrest e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 975/2022 të datës 24.02.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-malin zyrtar të datës 09.02.2022; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2021, për ankuesen i datës 26.01.2022.; Komunikimin për mes mesazheve telefonike të datës 24.02.2022; E-maliat zyrtar të datës 25.06.2021; 15.06.2021; 14.06.2021; 09.06.2021; E- 06.06.2021; 14.06.2021; 08.04.2021; 14.06.2021; 08.04.2021; 02.04.2021; 01.04.2021; 29.03.2021; 18.06.2021; 17.06.2021; 02.04.2021; 02.04.2021; E-malin 01.04.2021; E-malin zyrtar të datës 29.03.2021; 15.10.2021; 17.08.2020; 17.08.2020; 03.08.2020; 03.08.2020; 18.07.2020; 17.07.2020;; Provën shtesë me numër të protokollit 1283/2022 të datës 10.03.2022; Informatën shtesë për Komisionin Disiplinore nga Drejtori i Departamentit të Transparencës në Komuna në MPL; Emailat zyrtar 07.03.2022; 02.03.2022; 02.03.2022; 01.03.2022; 09.02.2022; 24.01.2022; 24.01.2022; 21.01.2021; 09.02.2022; 08.02.2022; 24.01.2022; E 24.01.2022; 21.01.2022; 13.07.2021; 13.07.2021; Komunikimin përmes mesazheve telefonike të datës 10.03.2022; PyetëSORIN për Zbatimin e Udhëzimit Administrative (MAPL) Nr.06/2018 për Standarde Minimale të Konsultimit Publik në Komuna të Monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës; E-malin zyrtarë të datës 14.06.2021; 09.06.2021; 25.06.2021; 15.06.2021; 02.03.2022; 01.03.2022; E 09.02.2022; Provat shtesë me numër të protokollit 1460/2022 të dërguara nga ankuesja me datën 21.03.2022; 18.03.2022; 18.03.2022; 17.03.2022; 16.03.2022; 15.03.2022; 28.02.2022; 25.02.2022; 22.02.2022; 18.02.2022; E-malin 14.02.2022; Emalin zyrtar të datës 12.02.2022; E-malin zyrtar të datës 21.03.2022; 18.03.2022; 18.03.2022; 18.03.2022; E-mailin zyrtar me numer të protkollit 1794/2022 të datës 04.04.2022; Raportin për periudhën 28 Qershor deri me 01 Korrik 2021; Raportin Javor të datës 14.10.2021; Raportin javor të datës 07.10.2021; Raportin javor të datës 29.07.2021; Raportin javor të datës 22.07.2022; Raportin javor të datës 18 Shkurt deri me 25 Shkurt 2021; Raporti mujor i datës 26 Gusht deri me 02 shtator 2021; E-malin zyrtar të datës 16.02.2022; Planin e Punës për vitin 2021; Raportin e datës 05 Prill deri me 09 Prill 2021; Shkrasa dhe foto lidhur me prezantimin e raportit të vitit 2020 nga Divizioni për Transparencë në Komuna; Emailin e datës 01.04.2022; 29.03.2022; E 28.03.2022; 25.03.2022; 22.03.2022; 04.02.2022; 03.02.2022; 01.04.2022; Raportin për periudhën Janar-Mars 2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1130/2022 të datës 02.03.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1295/2022 të datës 11.03.2022; Ndryshimin dhe plotesimin e aktit të emërimit të datës 17.12.2013; E-mailin zyrtar të datës 08.02.2022; Planin e punës për vitin 2021 për Departamentin për Performancë dhe Transparencë Komunale; Formularin për vleresimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesen; Raporti i monitorimit të transparencës Komunale Janar-Qershor 2021; E-malin zyrtar me numër të protokollit 1547/2022 të datës 23.03.2022; E-malin zyrtar të datës 23.03.2022; 15.06.2021; 14.06.2021; 30.03.2022; 01.02.2022; 31.01.2022.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit të datës 17.12.2013, është e punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit për Transparencë Komunale*, në kuadër të Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale.

Udhëheqësi i Departamentit të Performancës dhe Transparencës Komunale, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, me datë 26.01.2022 ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për vitin 2021, duke e vlerësuar të njëjtën me notën e përgjithshme 2.8.

Ankuesja e pakënaqur me këtë vlerësim, brenda afatit ligjor parashton ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga mbikëqyrësi i saj i drejtpërdrejt është jo objektiv, i padrejtë dhe tendenciozë dhe se janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zyrtaret Publikë dhe Rregullores për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ka analizuar nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit..... dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). Rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja përkitazi me objektivat e punës është vlerësuar nga mbikëqyrësi i saj me notë mesatare 2.7, për aftësitë është vlerësuar me notë mesatare 3, ku nota e përgjithshme rezulton 2.8. Mirëpo, Kolegji pasi ka analizuar notat e vlerësimit dhe pas ndjekjes së metodologjisë së vlerësimit të paracaktuar me nenin 10 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ka gjetur se kalkulimi i notave të vlerësimit nuk është në pajtim me metodologjinë e vlerësimit, përkatësisht nisur nga vlerësimi i objektivave dhe aftësive të bëra sipas Formularit të Vlerësimit të datës 26.01.2022, rrjedhë së nota mesatare për objektiva është 1.6, nota mesatare për aftësi është 1.60, kurse nota e përgjithshme 3.20.*

Andaj, bazuar në rrethanat si me lart dhe me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë obligohet Drejtori i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021 në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 10 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike më të cilin theksohet se: *1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën 60% të rezultateve përfundimtare të*



vlerësimin, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësve civilë përbën 40% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit. 2. Nota mesatare e objektivave kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë objektivave të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e objektivave të vlerësuar. 3. Nota mesatare e sjelljeve profesionale (aftësive) kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë aftësive të vlerësuara dhe duke pjesëtuar me numrin e aftësive të vlerësuar. 4. Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur 60% (shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe 40% (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësive.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit do të ndër marr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, siç u tha me sipër, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### Këshillë juridike:


Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciumi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.166/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit



#### Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretariat te Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit te Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit te Pushtetit Lokal; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.